



<b>REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO</b> <b>AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT</b> <b>AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE</b> <b>ANTI-CORRUPTION AGENCY</b>	
Dep. Dep. Dep. Nr. Ifaq. Broj stranica Nr. pages	2-0 / DPK  02  PHISHING
Nr. Prot. Bi-Prot. Prot No. Data Datum Date	01-263/14  24.01.2014



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (parografi 1.1), nenit 5 (parografi 1 pika 1.5), nenit 18 (parografi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupcionit si dhe nenit 24 (parografi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupcionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupcionit me datë 22.01.2014, mori:

**V E N D I M**

**I.** Mbyllt rasti me nr. AKK-03-4304/13, për z. Muhammed Avdiu – U.d Drejtor në Klinikën e Pediatrisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

**II.** Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

**A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Muhammed Avdiu – U.d Drejtor në Klinikën e Pediatrisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat A.S.P. "Avicena", është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartpërmendur, zyrtari i lartë z. Avdiu është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupcionit (me datë 23.12.2013), pas së cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë. Me këtë rast ai është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet të cilat duhet ti bëj për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Avdiu, në këtë takim ka dekluaruar se brenda afatit ligjor do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar në biznesin privat dhe do të vazhdoj të ushtroj funksionin e tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Avdiu ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë( DPKI.03- 168/14) në të cilën vërtetohet se i njëjtë ka hequr dorë nga pozita e personit të autorizuar që kishte në A.S.P. "Avicena".

Më këtë ai ka shhangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

**II.** Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrëthana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

